

**VENDIM**  
**Nr. 755, datë 30.11.2019**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 903, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 112, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidëve të punës", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 14, të vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 14.1, me këtë përmbajtje:

"14.1 Vetëm për vitin akademik 2019–2020 përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, studentët të cilët ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe janë anëtarë të familjeve që kanë humbur persona ose që janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, për shkak të tërmetit të datës 26.11.2019. Institucionet publike të arsimit të lartë identifikojnë studentët dhe dërgojnë listat e studentëve të identifikuar për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin."

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**